

KËRKESË
Nr. 957/7, datë 27.8.2018

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Brendshme shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikualifikim i qendrës së qytetit Çorovodë”, faza e dytë, Bashkia Skrapar.

Subjekti kërkuar është Bashkia Skrapar. Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët do të likuidohen për efekt shpronësimi me paraqitjen e dokumenteve të rregullta të pronësisë, pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave, që do të miratojë kërkesën për shpronësim. Vlera totale e shpronësimit është 2 467 950 (dy milionë e katërqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI I BRENDSHËM
Romina Kuko

LISTA EMËRORE E PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR REALIZIMIN E
PROJEKTTIT “RIVITALIZIMI I RRUGËS DËSHMORET, ÇOROVODË”, FAZA E DYTË, BASHKIA SKRAPAR

Nr.	Emri Mbiemri	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. e ndërtimit/ m ²	Vlera e përgj./lekë	Lloji i dokumentit
1	Gramoz Hysen Qafoku	1420	3/46	Ndërtesë	114	1 759 320	Vërtetim pronësie
2	Neshat Bajram Biraku	1420	4/10	Ndërtesë	35.1	708 630	Vërtetim pronësie
	TOTALI					2 467 950	